

# RAPORT MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT NË KOMUNËN E PRIZRENIT - 2025





# RAPORT MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT NË KOMUNËN E PRIZRENIT - 2025

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci Nr.67, Prizren,  
Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7

[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org)  
[info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)

029 222 771

Maj, 2026

## **Përmbajtja:**

HYRJE.....	4
GJETJET E RAPORTIT.....	6
Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor.....	6
Korniza ligjore.....	7
Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit.....	8
Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor.....	10
Menaxhimi i mbeturinave.....	12
Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave.....	14
Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike .....	15
Licencimi dhe lejet mjedisore.....	16
PËRFUNDIME.....	17
REKOMANDIMET.....	19
Për EC:.....	21

# **HYRJE**

Metodologjia për monitorimin mjedisor në nivel komunal është hartuar si instrument profesional për vlerësimin sistematik të gjendjes së mjedisit dhe funksionimit të mekanizmave institucionalë në komunat e Kosovës. Dokumenti synon të krijojë një kornizë të standardizuar për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave mjedisore, duke siguruar krahasueshmëri dhe koherencë ndërmjet komunave.

Kjo metodologji mbështetet në të dhëna primare të siguruar përmes pyetësorëve të strukturuar të plotësuar nga institucionet komunale përgjegjëse për çështjet mjedisore për periudhën janar - dhjetor 2025, si dhe në të dhëna sekondare të nxjerra nga raporte zyrtare komunale, dokumente institucionale dhe burime të tjera relevante që kontribuojnë në plotësimin dhe verifikimin e analizës.

Metodologjia e ndjekur nga EC Ma Ndryshe për përpilimin e këtij raporti merr në konsideratë 12 ligje që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, si:

Ligji nr.03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit

Ligji nr.03/L-233 për mbrojtjen e natyrës

Ligji nr.08/L-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja

Ligji nr.08/L-137 për pyjet e Kosovës

Ligji nr.04/L-147 për ujërat e Kosovës

Ligji nr.04/L-060 për mbeturina dhe Ligji nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e tij

Ligji nr.06/L-035 për veprimtaritë hidrometeorologjike

Ligji nr.08/L-065 për produktet biocide

Ligji nr.02/L-53 për gjuetinë

Ligji nr.04/L-197 për kimikate

Ligji nr.04/L-174 për planifikimin hapësinor

Ligji nr.04/L-175 për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit.

Metodologjia bazohet në analizën e këtyre komponentëve kryesorë të menaxhimit mjedisor:

- Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor
- Korniza ligjore
- Dokumentet e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor
- Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor
- Sistemet e monitorimit mjedisor
- Sistemet e menaxhimit të të dhënave mjedisore
- Bashkëpunimi dhe pjesëmarrja publike
- Licencimi dhe lejet mjedisore

Në këtë kuadër, analiza synon të trajtojë në mënyrë të strukturuar elementet kryesore që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi dhe praktikrat institucionale në nivel komunal.

Gjetjet e paraqitura në këtë dokument identifikojnë çështjet kryesore dhe sfidat aktuale në sektorin e mjedisit, duke reflektuar gjendjen reale në bazë të të dhënave të ofruara nga institucionet komunale. Këto gjetje evidentojnë nevojën për përmirësim të kapaciteteve institucionale, si dhe për forcimin e proceseve të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor.

Në funksion të kësaj analize, në pjesën përfundimtare janë paraqitur rekomandime konkrete, të cilat synojnë përmirësimin e praktikave ekzistuese dhe avancimin e menaxhimit mjedisor në nivel komunal, drejt një qasjeje më të qëndrueshme dhe efektive në mbrojtjen e mjedisit dhe resurseve natyrore.

## GJETJET E RAPORTIT

### Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Në Komunën e Prizrenit, përgjegjësitë për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor janë të organizuara në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Në kuadër të kësaj drejtorie funksionon Sektori i Mjedisit dhe Menaxhimit të Mbeturinave, i cili është përgjegjës për trajtimin e çështjeve mjedisore në nivel komunal.

Organi komunal	A është themeluar	Emri zyrtar	Fuqia punëtore
Drejtoria	Po	Drejtoria e Shërbimeve Publike	15
Sektori	Po	Sektori i Mjedisit dhe Menaxhimit të Mbeturinave	
Zyrtarë mjedisor	Po	Udhëheqësi i Sektorit të Mjedisit dhe Mbeturinave; Zyrtar për Mjedis; Zyrtar për Menaxhimin e Mbeturinave; Inspektori për Mjedis; Shërbyesi në sportel (arkëtar)	5
Drejtoria	Po	Drejtoria e Inspektoriateve	
Sektori	Po	Inspektori Komunal për çështje mjedisore	1

Tabela 1. Skema institucionale lokale për menaxhimin mjedisor

Sa i përket kapaciteteve njerëzore, evidentohet mungesë e stafit të dedikuar për çështje

Sa i përket kapaciteteve njerëzore, numri i shërbyesve civil vlerësohet i mjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore.

Po ashtu, shërbyesit civil posedojnë profilet e nevojshme profesionale për kryerjen e këtyre detyrave.

Në aspektin e përgatitjes profesionale, stafi vlerësohet në nivel të mirë (4/5).

Janë organizuar trajnime nga niveli qendror dhe organizata të tjera, duke përfshirë:

- Anketë mbi prioritetet e menaxhimit të ujërave të ndotura
- Aktivitetin “Prizreni i qëndrueshëm: Zhvillimi qarkor, zgjidhjet e bazuara në natyrë dhe planifikimi pjesëmarrës”
- Punëtori për menaxhimin e integruar të mbeturinave dhe ekonominë qarkore
- Punëtori në kuadër të hartimit të Ligjit për Mbeturina
- Aktivitete dhe vlerësime nga Community Development Fund (CDF)
- Punëtori të organizuara nga Asociacioni i Komunave të Kosovës në bashkëpunim me GIZ

Komuna shfrytëzon udhëzues dhe dokumente të zhvilluara nga niveli qendror dhe organizata të tjera për menaxhimin e çështjeve mjedisore, përfshirë ligjet përkatëse dhe dokumente strategjike në fuqi.

### **Korniza ligjore**

Komuna e Prizrenit, përkatësisht Sektori i Mjedisit dhe Menaxhimit të Mbeturinave, në ushtrimin e përgjegjësive në fushën e mjedisit mbështetet në një sërë ligjesh dhe dokumentesh sektoriale.

Ligjet dhe dokumentet kryesore të përdorura për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor janë:

- Ligji Nr. 02/L-30 për menaxhimin e Mbeturinave
- Rregullorja Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave Nr. 01/011-31308, 19 shtator 2015
- Plani Pesëvjeçar 2013-2018 shtator 2013
- Plani Master 2014-2023 Nr. 01/011-161014, 03 shtator 2015
- Ligji Nr. 03/L-024 - Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
- Ligji Nr. 03/L-25 për Mbrojtjen e Mjedisit
- Ligji NR. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës
- Ligji nr. 03/L-160 për mbrojtjen e ajrit
- Ligji Nr.04/ L-147 për ujërat e Kosovës.
- Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma

Korniza ligjore mjedisore vlerësohet si e konsoliduar, megjithatë theksohet se secila komunë ka karakteristikat dhe sfidat e veta specifike.

Sa i përket mangësive, evidentohet se komuna aktualisht operon me Planin Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM) të periudhës 2014-2018 dhe është në proces të hartimit të një plani të ri.

Në aspektin e njohurive të stafit për kornizën ligjore, ato vlerësohen në nivel të mirë.

**Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit**

Komuna e Prizrenit ka hartuar dokumente të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor në përputhje me kërkesat që rrjedhin nga korniza ligjore në fuqi.



Dokumentet kryesore të identifikuara përfshijnë:

Planin Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM) të periudhës 2014–2018, ndërsa komuna është në procedurë të hartimit të një plani të ri më gjithëpërfshirës.

Sipas të dhënave të siguruara, strategjitë mjedisore lokale janë të harmonizuara me strategjitë e nivelit qendror.

Sa i përket zhvillimit të projekteve mjedisore, Sektori i Mjedisit dhe Menaxhimit të Mbeturinave realizon aktivitete dhe projekte të ndryshme që lidhen me përmirësimin e gjendjes së mjedisit.

Projektet dhe aktivitetet kryesore përfshijnë:

Nr.	Përshkrimi i kontratës	Referenca	Afati i kontratës	Vlera (€)	Kontraktuesi
1	Menaxhimi i mbeturinave, grumbullimi, transporti dhe deponimi në komunën e Prizrenit	01-063/25 (30.01.2025)	30.01.2025 29.01.2025		KRM Ekoregjioni
2	Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve ( Fshirja, larja dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbra publike) në komunën e Prizrenit, Zona I-II	01-579/25 30.09.2025	01.10.2025 0.09.2025	4,653.875.8 8	KRM Ekoregjioni
3	Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve (Fshirja, larja dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbra publike) në komunën e Prizrenit, Zona III	01-401/25 07. 07.2025	07.07.2025 06.07.2028	1,749,102.00	KRM Ekoregjioni

Tabela 2. Projektet kryesore mjedisore në Komunën e Prizrenit

Përveç këtyre kontratave, komuna realizon edhe aktivitete të tjera mjedisore, si:

- Kontrata për rregullimin dhe zhvillimin e parqeve;
- Fushata për pastrimin e hapësirave publike;
- Mbjellja e pemëve dhe krijimi i hapësirave të reja të gjelbra;
- Aktivitete edukative dhe sensibilizuese për ruajtjen e mjedisit;
- Edukimi dhe promovimi i menaxhimit të duhur të mbeturinave tek qytetarët.

Masat për mbrojtjen e mjedisit janë të integruara brenda projekteve komunale dhe dokumenteve të planifikimit dhe nuk paraqiten si aktivitete të veçanta të ndara.

Në kuadër të masave institucionale, komuna realizon raportime të rregullta për mjedisin dhe mbeturinat në platformën online të Ministrisë së Pushtetit Lokal, përmes së cilës të dhënat përpunohen dhe publikohen në nivel qendror.

Në përgjithësi, komponenti mjedisor është i integruar në aktivitetet dhe dokumentet e planifikimit komunal, me fokus në menaxhimin e mbeturinave, mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve.

### **Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor**

Inspektimi i zbatimit të kornizës ligjore për mbrojtjen e mjedisit në Komunën e Prizrenit realizohet në nivel komunal përmes Drejtorisë së Inspektoratit.

Sa i përket raportimit të inspektimeve, hartohen evidenca dhe dokumentacion përkatës për aktivitetet inspektive, duke përfshirë procesverbalet, aktvendimet dhe masat e ndërmarra gjatë vitit.

Gjatë vitit raportues janë realizuar këto aktivitete inspektive:

Lënda	Jan ar	Shku rt	Mar s	Pri ll	Ma j	Qersh or	Korri k	Gus ht	Shtat or	Teto r	Nënt or	Dhjet or	Tota li
Procesverbale të hartuara	9	8	10	9	11	12	7	10	9	4	5	5	99
Aktvendime	0	0	2	0	1	1	0	0	1	1	1	1	8
Kërkesat për Gjykatë	0	0	1	0	0	4	2	1	0	0	0	0	8
Gjoha Administrative	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjoha Mandatore	0	0	1	0	0	1	0	0	0	0	0	0	2
Realizuar nga Gjykata	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Rekomandime	2	3	1	3	2	1	2	3	1	5	4	2	29
Numri i objekteve të inspektuara për LMK	2	2	1	3	0	4	2	1	1	1	1	0	18
Numri i objekteve të pajisura me LMK	2	2	1	3	0	4	2	1	1	1	1	0	18

Tabela 3. Aktivitetet inspektive gjatë vitit

Nuk janë shqiptuar gjoha administrative gjatë kësaj periudhe, derisa janë shqiptuar 2 gjoha mandatore.

Sa i përket monitorimit të strategjive mjedisore, nuk hartohen raporte të veçanta të monitorimit, megjithatë aktivitetet zhvillohen në përputhje me Planin Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM) 2014-2018, i cili mbetet dokumenti referues, ani pse prej vitesh nuk është rifreskuar me të dhëna.

Gjendja e deponive të mbeturinave nuk monitorohet në mënyrë sistematike.

Gjithashtu, nuk janë realizuar vlerësime të ndikimit të deponive ekzistuese në mjedis.

Sa i përket çrregullimeve mjedisore, janë identifikuar raste të hedhjes së paligjshme të mbeturinave, veçanërisht në brigjet e lumenjve, të cilat paraqesin problem të vazhdueshëm dhe kërkojnë ndërhyrje institucionale dhe rritje të ndërgjegjësimit qytetar.

Ndërsa rastet e tejkalimit të eksploatimit të resurseve natyrore trajtohen nga Drejtoria e Inspektoratit dhe konsiderohen si pjesë e kompetencave përkatëse institucionale.

### **Menaxhimi i mbeturinave**

Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Prizrenit paraqet një sektor me rëndësi të veçantë për menaxhimin mjedisor, duke reflektuar një volum të lartë të mbeturinave dhe një shtrirje të gjerë të shërbimit.

Vlerësimi i gjendjes mbështetet në të dhënat e raportuara nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës për vitet 2023 dhe 2024.

Sipas të dhënave, numri i banorëve të shërbyer në Komunën e Prizrenit ka qenë 202,313 në vitin 2023, ndërsa në vitin 2024 është raportuar 151,821 banorë të përfshirë në shërbim, duke reflektuar një ulje prej 50,492 banorësh.<sup>1</sup>

Megjithatë, kjo rënie nuk duhet interpretuar si ndryshim real demografik apo në nivelin e mbulimit me shërbim, por lidhet kryesisht me dallimet në metodologjinë e raportimit dhe evidentimit të banorëve të shërbyer ndërmjet viteve.

---

<sup>1</sup> Raporti i AMMK për menaxhimin e mbeturinave komunale në Kosovë, publikuar në vitin 2025, linku: <https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/ALB%20Raporti%20per%20gjendjen%20e%20mbeturinave%20ne%20Kosove%202023-2024.pdf>

Sa i përket sasisë së mbeturinave, gjatë vitit 2023 janë grumbulluar gjithsej 49,166 ton mbeturina komunale, ndërsa në vitin 2024 kjo sasi është rritur në 52,072 ton, duke reflektuar një rritje prej 2,906 ton.<sup>2</sup>

Ndërkohë, gjenerimi i mbeturinave për banor ka qenë 243.02 kg/banor/vit në vitin 2023, ndërsa në vitin 2024 është rritur në 342.98 kg/banor/vit, që paraqet një rritje të konsiderueshme prej 99.96 kg/banor/vit.<sup>3</sup>

Treguesi	2023	2024	Ndryshimi
Numri i banorëve të shërbyer	202,313	151,821	-50,492
Sasia e mbeturinave (ton/vit)	49,166	52,072	+2,906
Sasia e mbeturinave (kg/vit)	49,166,000	52,072,000	+2,906,000
Gjenerimi i mbeturinave (kg/banor/vit)	243.02	342.98	+99.96
Gjenerimi i mbeturinave (kg/banor/ditë)	0.67	0.94	+0.27
Shkalla e mbulimit me shërbim (%)	100.0%	100.0%	0%

Tabela 4. Statistikat kryesore për menaxhimin e mbeturinave - Komuna e Prizrenit

Të dhënat tregojnë një rritje të sasisë së mbeturinave të grumbulluara në Komunën e Prizrenit gjatë vitit 2024 krahasuar me vitin 2023, e shoqëruar me një rritje të konsiderueshme të gjenerimit të mbeturinave për banor.

Megjithatë, kjo rritje duhet të interpretohet me kujdes, pasi në të njëjtën kohë evidentohet një rënie e madhe në numrin e banorëve të shërbyer, e cila nuk lidhet me ndryshim real në mbulimin me shërbim (i cili mbetet

<sup>2</sup> Po aty

<sup>3</sup> Po aty

100%), por me dallime në metodologjinë e raportimit të të dhënave ndërmjet viteve.

Në këtë kontekst, rritja e dukshme e gjenerimit të mbeturinave për banor është kryesisht rezultat i ndryshimeve në bazën e të dhënave dhe jo domosdoshmërisht i një rritjeje reale të prodhimit të mbeturinave.

Në përgjithësi, sistemi i menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Prizrenit paraqitet funksional dhe me mbulim të plotë, ndërsa dallimet e theksuara në tregues theksojnë nevojën për standardizim të metodologjisë së raportimit dhe përmirësim të sistemeve të menaxhimit të të dhënave.

### **Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemi të menaxhimit të dhënave**

Komuna e Prizrenit nuk ka sistem funksional të monitorimit të cilësisë së ajrit, megjithëse janë vendosur 7 stacione (sensorë) për matjen e cilësisë së ajrit në këto lokacione:

Reçan; Lutogllavë; Piranë; Gjonaj; Zhur (Vlashnje); Motrat Qiriazzi (Kurillë); Remzi Ademaj.

Gjithashtu, Drejtoria e Shërbimeve Publike posedon aparate për matje të ndryshme të biodiversitetit, mirëpo ato nuk janë përdorur nga zyrtarët përkatës.

Nuk realizohet mbikëqyrje sistematike e cilësisë së ajrit.

Sa i përket monitorimit të dheut, komuna nuk ka sistem të tillë dhe nuk realizohet mbikëqyrje sistematike e tij.

Në aspektin e monitorimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, komuna nuk ka sistem funksional dhe nuk disponon të dhëna për stacione monitorimi apo intervale të matjes.

Komuna e Prizrenit nuk ka ndërtuar sistem të menaxhimit të të dhënave mjedisore.

Po ashtu, nuk posedon kapacitetet e nevojshme teknike për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore.

Në aspektin njerëzor, kapacitetet për menaxhimin e të dhënave mjedisore janë të kufizuara, çka ndikon në mungesën e një sistemi të strukturuar dhe funksional për analizimin dhe përdorimin e të dhënave në vendimmarrje.

### **Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike**

Bashkëpunimi dhe koordinimi me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore vlerësohet në nivel të mirë (4 nga 5). Një nga rastet e bashkëpunimit përfshin realizimin e një analize mbi gjendjen mjedisore të lumenjve në territorin e komunës, e cila është përgatitur dhe dërguar në Ministrinë e Mjedisit, megjithatë pa kthim përgjigje nga institucionet qendrore.

Bashkëpunimi me nivelin qendror në hartimin e strategjive mjedisore gjithashtu vlerësohet në nivel të mirë (4 nga 5). Në këtë kuadër është zhvilluar një punëtori e përbashkët me komunat dhe nivelin qendror lidhur me hartimin e Ligjit për Mbeturina dhe Mjedis, e organizuar nga GIZ, mirëpo pas kësaj nuk ka pasur vazhdimësi të bashkëpunimit.

Sa i përket bashkëpunimit me organizatat joqeveritare, ai vlerësohet në nivel shumë të kënaqshëm (5 nga 5). Komuna ka bashkëpunuar me organizata si EC Ma Ndryshe dhe GIZ, përmes realizimit të aktiviteteve, diskutimeve me komunitetin dhe dhënies së rekomandimeve që kanë kontribuar në përmirësimin e çështjeve mjedisore në nivel lokal.

Në aspektin e pjesëmarrjes publike, komuna në bashkëpunim me MMPHI ka zhvilluar procese konsultimi publik gjatë hartimit të iniciativave mjedisore,

përfshirë prezantimin publik të iniciativës për zgjerimin e deponisë në Landovicë.

Megjithatë, niveli i pjesëmarrjes publike në këto procese vlerësohet i ulët (2 nga 5).

### **Licencimi dhe lejet mjedisore**

Licencimi dhe dhënia e lejeve për shfrytëzimin dhe menaxhimin e resurseve mjedisore në përgjithësi nuk janë në kompetencë të plotë të nivelit komunal dhe realizohen nga institucionet e nivelit qendror.

Në nivel komunal, lëshohen leje mjedisore për kategori të caktuara të aktiviteteve, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Gjatë periudhës 01.01.2025 – 31.05.2025, janë trajtuar kërkesat për leje mjedisore si më poshtë:

<b>Datë</b>	<b>Lëndë të bartura</b>	<b>Lëndë të pranuarra 2025</b>	<b>Lëndë të shqyrtuara</b>	<b>Të Pazgjdhura</b>	<b>Të aprovuara</b>	<b>Të refuzuara</b>	<b>Të pezulluara</b>
03.01.2025	1	119	105	0	105	7	7

Tabela 5. Lejet mjedisore (Janar - Maj 2025)

Këto të dhëna tregojnë se pjesa më e madhe e kërkesave të trajtuara janë aprovuar, ndërsa një numër më i vogël i tyre janë refuzuar ose pezulluar gjatë procesit të shqyrtimit.



## **PËRFUNDIME**

Analiza e gjendjes së menaxhimit mjedisor në Komunën e Prizrenit tregon se ekziston një bazë funksionale institucionale dhe ligjore për trajtimin e çështjeve mjedisore, megjithatë sfidat kryesore lidhen me implementimin, monitorimin dhe menaxhimin e të dhënave.

Struktura institucionale është e vendosur dhe funksionale, me ndarje të qartë të përgjegjësisive ndërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Drejtorisë së Inspektoratit. Kapacitetet njerëzore vlerësohen në nivel të mirë, ndërsa stafi posedon njohuri të mjaftueshme për zbatimin e kornizës ligjore. Megjithatë, kompleksiteti i çështjeve mjedisore kërkon forcim të mëtejshëm të kapaciteteve teknike dhe organizative.

Korniza ligjore është e konsoliduar dhe në përputhje me legjislacionin qendror, por përdorimi i dokumenteve strategjike të vjetruara, si PLVM 2014–2018, tregon nevojën për përditësim dhe përshtatje me zhvillimet aktuale.

Në aspektin e planifikimit dhe zbatimit, komuna realizon një numër të konsiderueshëm projektesh dhe aktiviteteve mjedisore, duke reflektuar integrimin e komponentit mjedisor në menaxhimin komunal. Megjithatë, mungesa e ndarjes së qartë të masave mjedisore dhe indikatorëve të matshëm kufizon vlerësimin e efektivitetit të këtyre ndërhyrjeve.

Aktivitetet inspektive janë të zhvilluara dhe tregojnë angazhim të vazhdueshëm në zbatimin e ligjit, por mungesa e një sistemi të strukturuar raportimi dhe monitorimi kufizon analizën e trendëve dhe planifikimin strategjik.

Në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, sistemi paraqitet funksional dhe me mbulim të plotë, ndërsa rritja e gjenerimit të mbeturinave dhe mospërputhjet në të dhëna tregojnë nevojën për standardizim të metodologjisë së raportimit.

Një ndër sfidat kryesore është mungesa e sistemeve funksionale të monitorimit mjedisor dhe menaxhimit të të dhënave. Edhe pse ekzistojnë disa pajisje dhe stacione, ato nuk përdoren dhe nuk ka monitorim sistematik të ajrit, ujit dhe dheut.

Bashkëpunimi institucional paraqitet në nivel të mirë me institucionet qendrore dhe shumë i mirë me organizatat joqeveritare, ndërsa pjesëmarrja publike mbetet e ulët dhe kërkon përmirësim.

Në përgjithësi, Komuna e Prizrenit ka një bazë të mirë për menaxhimin mjedisor, por përmirësimi i sistemeve të monitorimit, menaxhimit të të dhënave dhe planifikimit strategjik mbetet kyç për zhvillim të qëndrueshëm.

## REKOMANDIME

- 1** Të përshpejtohet hartimi dhe miratimi i Planit të ri Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM), duke siguruar që ai të përfshijë indikatorë të matshëm dhe mekanizma të qartë monitorimi.
- 2** Të zhvillohet dhe funksionalizohet një sistem i integruar për monitorimin e komponentëve kryesorë mjedisorë (ajri, dheu dhe uji), duke shfrytëzuar stacionet ekzistuese dhe pajisjet në dispozicion.
- 3** Të krijohet një sistem i strukturuar për menaxhimin e të dhënave mjedisore, i cili mundëson grumbullimin, analizën dhe raportimin e të dhënave në mënyrë të vazhdueshme dhe të standardizuar.
- 4** Të rritet përdorimi i pajisjeve ekzistuese për monitorim mjedisor dhe të sigurohet trajnimi i stafit për përdorimin e tyre efektiv.
- 5** Të forcohen kapacitetet teknike dhe profesionale të stafit përmes trajnimeve të vazhdueshme në fushën e monitorimit, analizës së të dhënave dhe politikave mjedisore.
- 6** Të përmirësohet sistemi i raportimit inspektiv përmes krijimit të një databaze të centralizuar, e cila mundëson analizë të trendëve dhe planifikim më të mirë të ndërhyrjeve.
- 7** Të zhvillohen mekanizma për monitorimin e rregullt të deponive të mbeturinave dhe për realizimin e vlerësimeve të ndikimit të tyre në mjedis.

**8** Të standardizohet metodologjia e mbledhjes dhe raportimit të të dhënave për menaxhimin e mbeturinave, në mënyrë që të sigurohet krahasueshmëri ndërmjet viteve.

**9** Të forcohet bashkëpunimi me institucionet e nivelit qendror përmes përfshirjes më aktive në hartimin e politikave dhe strategjive mjedisore.

**10** Të rritet bashkëpunimi me organizatat joqeveritare përmes zhvillimit të projekteve të përbashkëta dhe shfrytëzimit të ekspertizës së tyre.

**11** Të përmirësohen mekanizmat e pjesëmarrjes publike, duke nxitur përfshirje më të gjerë të qytetarëve në proceset e konsultimit dhe vendimmarrjes.

**12** Të fuqizohet roli i komunës në proceset e licencimit përmes përmirësimit të koordinimit me nivelin qendror, në mënyrë që të shmangen vonesat dhe të rritet efikasiteti i vendimmarrjes.

## **Për EC:**

EC Ma Ndryshe është organizatë me bazë në komunitet, e themeluar në vitin 2006, që angazhohet për zhvillim të qëndrueshëm me qasje gjithëpërfshirëse. Aktivizmi i EC-it synon një Kosovë ku qeverisja demokratike është pjesëmarrëse, transparente dhe llogaridhënëse, duke siguruar që institucionet, komunitetet dhe palët e interesit të punojnë së bashku drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Ky vizion promovon vendimmarrjen gjithëpërfshirëse, politika më të fuqishme dhe përfshirje më të madhe të publikut, duke siguruar që qëndrueshmëria të jetë pjesë përbërëse e qeverisjes si në nivel lokal, ashtu edhe në atë kombëtar. Përmes koordinimit më të mirë institucional, hartimit të politikave të bazuara në dëshmi dhe angazhimit qytetar, angazhimi i EC-it synon të kapërcejë hendekun mes komuniteteve dhe institucioneve, duke siguruar që qeverisja e mirë të sjellë ndryshime të prekshme dhe afatgjata.

## **Deklarata e vizionit**

“Fuqizimi i një Kosove elastike dhe gjithëpërfshirëse, ku komunitetet në mënyrë aktive formojnë institucione të qëndrueshme, të digjitalizuara dhe të ndërgjegjshme”.

## **Deklarata e misionit**

“EC Ma Ndryshe përkrah qeverisjen demokratike dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm socioekonomik, kulturor dhe të gjelbër përmes edukimit digjital, kujdestarisë mjedisore, mobilizimit të komuniteteve, avokimit për vendimmarrje publike me pjesëmarrje dhe kultivimit të partneriteteve strategjike”.

**EC**  
MA NDRYSHE



[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org)